

7 Shkurt 2013

KODI I SJELLJES

“ Për përdorimin e sigurtë dhe të përgjegjshëm të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Shqipëri”

7 Shkurt 2013



KODI I SJELLJES
PËR PËRDORIMIN E SIGURT DHE TË PËRGJEGJSHËM
TË RRJETEVE & SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE NË SHQIPËRI

Hyrje:

- A. Ky Kod Sjelljeje është përgatitur në mbështetje me Ligjin “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, ‘Planin e Veprimit për fëmijë 2012 -2015’ miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 182 datë 13.03.2012, legjislacionin shqiptar në fuqi dhe praktikën më të mirë evropiane në këtë drejtim; “Parimet për Rrjete Sociale me të Sigurta për vendet e BE”, të Komisionit Evropian publikuar në Shkurt të vitit 2009 si dhe dokumentin “Kudri Evropian për një përdorim më të Sigurt të Celularit nga Adoleshentet dhe Fëmijët”, nënshkruar nga operatorë të ndryshëm të mëdhenj në Evropë në Shkurt të vitit 2007.
- B. Të gjithë sipërmarrësit që ofrojnë Rrjete dhe/ose Shërbime të Komunikimeve Elektronike në Shqipëri (“**Sipërmarrësit**”), pavarësisht teknologjisë nëpërmjet së cilës ofrohen këto shërbime, luajnë një rol të rëndësishëm për të garantuar përdorimin e sigurt të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, aksesit në internet dhe pajisjeve respektive si dhe për të mbrojtur përdoruesit në moshën nën 18 vjeç.
- C. Ky Kod Sjelljeje (“**Kodi**”) synon të zhvillojë një praktikë për vete-rregullimin e sjelljes dhe praktikave të sipërmarrësve në industrinë e komunikimeve elektronike në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve, për të ofruar një përdorim të sigurt të rrjeteve, shërbimeve dhe pajisjeve në përputhje me kuadrin ekzistues ligjor dhe rregullator. Ky Kod synon gjithashtu dhe përgatitjen e procedurave që rregullojnë aksesin në përmbajtjen komerciale dhe shërbimet përkatëse që ofrohen ose aksesohen përmes rrjeteve dhe pajisjeve të sipërmarrësve, mbështetur në parimin e teknologjisë neutrale.
- D. Kodi përcakton standardet që sipërmarrësit dëshirojnë të shohin si të arritshme dhe në përmbushje të nevojave të klientëve dhe të industrisë, duke qenë gjithmonë në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi si dhe rregulloret e zbatueshme me këtë objekt. Nëpërmjet këtij Kodi, sipërmarrësit synojnë të vendosin:
- Mekanizma të përshtatshme të kontrollit të aksesit për përdoruesit në moshën nën 18 vjeç të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe pajisjeve që mundësojnë aksesin në to;
 - Klasifikim të përmbajtjes komerciale të ofruar nga sipërmarrësit;
 - Ndërgjegjësim dhe edukim të publikut dhe në veçanti, të prindërve apo kujdestarëve për përgjegjësinë prindërore në lidhje me përdorimin e internetit, përmbajtjes, shërbimeve dhe pajisjeve të aksesit nga adoleshentët dhe fëmijët;
 - Procedurat e raportimit.
- E. Kodi do të rishikohet dhe përmirësohet vazhdimisht në mënyrë që t’i përshtatet zhvillimeve legjislative, rregullatore dhe të teknologjisë dhe pritshmërive sociale.

- F. Në përputhje me parashikimet e Kodit, sipërmarrësit synojnë të ndërgjegjësojnë prindërit dhe kujdestaret për një sjellje të përgjegjshme në lidhje me aksesin në internet dhe komunikimet elektronike, si dhe t'iu ofrojnë atyre informacion dhe mjete të përshtatshme për të mbrojtur fëmijët e tyre në mënyrë efektive. Kjo është një nga pikat kryesore në nxitjen për një përdorim të sigurt të rrjeteve të komunikimeve elektronike, të shërbimeve dhe përmbajtjes komerciale, si dhe pajisjeve të aksesit nga klientët në moshën nën 18 vjeç.
- G. Duke mbajtur këtë në vëmendje, sipërmarrësit do të bashkëpunojnë me partnere të tjerë, të cilët nuk e zbatojnë këtë Kod, në mënyrë që të bëjnë me efektiv zbatimin e këtij Kodi. Sipërmarrësit angazhohen të bëjnë të gjitha përpjekjet e tyre për të marrë të gjitha masat për zbatimin e kushteve të këtij Kodi nëpërmjet marrëveshjeve kontraktore me sipërmarrësit e kontraktuar.
- H. Ky Kod nuk do t'i pengojë sipërmarrësit të zbatojnë dhe me tej masat mbrojtëse, por do të përcaktojë vetëm disa detyrime minimale, për aq kohë sa parashikimet e shtuara nuk vijnë në kundërshtim me përmbajtjen bazë të miratuar në Kod.
- I. Mbështetësit e këtij Kodi, përgjatë përcaktimit të strategjive të tyre individuale për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve, mbajnë në vëmendje natyrën specifike të shërbimeve që ofrojnë në mënyrë që të zbatojnë ato parime që janë të përshtatshme për veprimtarinë e tyre. Në këto kushte, sipërmarrësit bien dakord që të mbështesin këtë Kod dhe të gjithë parimet e përfshira në të, sidoqoftë do të mbetet në vendimmarrjen e gjithsecilit prej tyre të gjykojnë dhe të vendosin se cilin prej parimeve dhe deri në çfarë mase do t'i zbatojnë ato. Këto parime janë të natyrës frymëzuese dhe ndërgjegjësuese dhe nuk janë ligjërish të detyrueshme, por u ofrohen sipërmarrësve në formë rekomandimi për zbatim.

PËRKUFIZIME:

- **Kontrollet e Aksesit:** – metoda për të parandaluar aksesin e pakufizuar ndaj përmbajtjes komerciale të ose të papërshtatshme për përdoruesit nën 18 vjeç.
- **Verifikimi i moshës:** – procesi ku nëpërmjet masave dhe hapave të arsyeshëm verifikohet se klienti është mbi 18 vjeç, që përfshin por nuk kufizohet me disponueshmërinë e aplikacioneve të vetë deklarimit, kontrollin e dokumenteve që përmbajnë datëlindjen e klientit, kontrollin vizual të klientit për verifikimin e moshës, një transaksion të vlefshëm nëpërmjet kartës së kreditit, konfirmim/miratim/pëlqim paraprak elektronik, etj.
- **Përmbajtja komerciale** – është përmbajtja e ofruar nga sipërmarrësit klientëve të tyre, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Përmbajtja komerciale përfshin foto statike, video (përfshirë rastet kur ofrohen si Shërbime me Vlerë të Shtuar), lojëra që aksesohen nga pajisjet e komunikimit elektronik (përfshi lojërat e bazuara në programin Java), muzikë, etj.
- **Përmbajtje e ofruar në Internet** – përmbajtje që aksesohet në Internet ku sipërmarrësit ofrojnë vetëm lidhjen dhe nuk mund të ushtrojnë asnjë lloj ndikim komercial apo ndikim tjetër, mbi llojin e përmbajtjes së ofruar klientit.

- **Sipërmarrësit** – sipas përcaktimit në Ligjin 9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” ky term i referohet çdo personi fizik ose juridik sipas legjislacionit në fuqi, i cili është i autorizuar të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë dhe nënshkruan e zbaton rregullat dhe detyrimet e këtij Kodi.

ZBATIMI I KODIT

1. Klasifikimi i Përmbajtjes Komerciale

- 1.1 Sipërmarrësit pohojnë dhe pranojnë se në Shqipëri nuk ekzistojnë standarde dhe rregullore të qarta në lidhje me klasifikimin e përmbajtjes komerciale dhe kur këto të fundit të miratohen, sipërmarrësit do të veprojnë plotësisht në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe rregullatore.
- 1.2 Deri atëherë, sipërmarrësit do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se **përmbajtja komerciale** e ofruar nga ose nëpërmjet tyre, për aq sa kjo përmbajtje komerciale kontrollohet nga sipërmarrësit, do të klasifikohet brenda një kuadri të përshtatshëm.
- 1.3 Klasifikimi, do të shërbejë për të garantuar se përmbajtja komerciale do të ‘shënjohet’ për të dalluar nëse është ose jo e përshtatshme për klientin nën moshën **18 vjeç**. Rregulli i përgjithshëm është që nëse përmbajtja në fjalë do të renditej si përmbajtje për moshën **mbi 18 vjeç** nga standarde dhe institucione të njohura ndërkombëtarisht apo media, atëherë duhet të klasifikohet si **mbi 18** edhe në këtë Kuadër Klasifikimi.
- 1.4 Ky kuadër do të jetë në përputhje me standardet kombëtare të përdorura në media dhe do të trajtojë si të përshtatshme për moshën **mbi 18 vjeç** vetëm përmbajtjen komerciale që konsiderohet si e tillë në materiale ekuivalente, për shembull në: filma, video dhe lojëra kompjuterike.
- 1.5 **Ofruesit e përmbajtjes komerciale** do të vetë-klasifikojnë si materiale për **mbi 18 vjeç** të gjitha përmbajtjet komerciale të papërshtatshme për klientët nën moshën 18 vjeç, në përputhje me parashikimet e kuadrit si më sipër.
- 1.6 Automatikisht, të gjitha përmbajtjet komerciale që nuk janë klasifikuar material për të rritur **mbi 18 vjeç** do të konsiderohen si të pranueshme për të t’u aksesuar nga të miturit nën 18 vjeç.
- 1.7 Përmes marrëdhënies së tyre kontraktore me palët e treta, sipërmarrësit do të bëjnë përpjekjet maksimale që të tretet të klasifikojnë përmbajtjen komerciale në të njëjtën mënyrë sipas Klasifikimit të mësipërm.

2. Kontrollat e aksesit

- 2.1 Secili sipërmarrës do të vendosë në dispozicion përmbajtjen komerciale të klasifikuar si material për të rritur **mbi 18 vjeç** përmes **kontrolleve të aksesit** dhe do ta vendosë në

dispozicion vetëm të klientëve **mbi 18 vjeç**, të cilët janë verifikuar paraprakisht përmes **procesit të verifikimit të moshës**.

- 2.2 Sipërmarrësit do të bëjnë përpjekje për të zbatuar mjete të përshtatshme me qëllim **kontrollin mbi aksesin ndaj përmbajtjes komerciale** dhe të aplikojnë **procesin e verifikimit të moshës** edhe në ato raste kur përmbajtja, e cila i ofrohet nga një palë e tretë, sipas këtij klasifikimi, do të klasifikohet e përshtatshme vetëm për klientë të rritur mbi 18 vjeç.
- 2.3 Gjithashtu, sipërmarrësit do të bëjnë përpjekjet e tyre maksimale për të ofruar këshilla dhe udhëzime praktike si dhe zgjidhje konkrete që mund të përdoren nga prindërit për të përshtatur aksesin në rrjete, shërbime dhe përmbajtje komerciale nga fëmijët nën moshën 18 vjeç. Këto mund të përfshijnë udhëzime për prindërit, fletëpalosje, shërbime të veçanta, aplikacione për pajisje të komunikimit elektronik, bllokim ose filtrim, dhe/ose kontroll të faturimit.

3. Përmbajtja e Internetit

- 3.1 Sipërmarrësit pohojnë dhe pranojnë se nuk kanë kontroll mbi Përmbajtjen që ofrohet në Internet dhe prandaj nuk mund të ngulmojnë që kjo përmbajtje të klasifikohet në përputhje me klasifikimin e përdorur për përmbajtjen komerciale të përmendur në pikën 1 si me sipër, apo të kontrollohet, dhe raportohet.

4. Përmbajtja e paligjshme

- 4.1 Përmbajtja e paligjshme rregullohet nga dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Sipërmarrësit pohojnë dhe pranojnë së në Shqipëri nuk ka standarde dhe rregullore të plota në lidhje me përmbajtjen e paligjshme, dhe kur këto të miratohen, Sipërmarrësit do t'i respektojnë plotësisht këto të fundit.
- 4.2 Deri atëherë, sipërmarrësit angazhohen të vazhdojnë punën në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet ligjore, për zbatimin e detyrimeve sipas legjislacionit penal në fuqi, rast pas rasti.

5. Raportimi

- 5.1 Sipërmarrësit, nëpërmjet strukturave ekzistuese do të sigurojnë që klientët të kenë akses të menjëhershëm ndaj mekanizmave (për shembull linjat e shërbimit të klientit) për të raportuar shqetësimet në lidhje me përmbajtjen komerciale të ofruar nga sipërmarrësit, e konsideruar si e papërshtatshme, klasifikimet e përmbajtjes komerciale, si dhe çështje të tjera të sigurisë.
- 5.2 Sipërmarrësit do të sigurohen se këto raportime do të trajtohen me shpejtësi dhe do të merren masat përkatëse për korrigjimin në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5.3 Për qëllime të raportimit, klienti fillimisht do të kontaktojë ofruesin e shërbimit/rrjetit dhe t'i shpjegojë natyrën e ankesës/kërkesës së tij. Numrat e kontaktit do të mund të gjenden në faqet zyrtare të çdo sipërmarrësi. Pas marrjes së ankesës/kërkesës së konsumatorit, sipërmarrësi do të këshillojë dhe komunikojë përgjigjen në lidhje me ankesën dhe do të marrë masat përkatëse, nëse është e nevojshme.

5.4 Nëse klienti nuk është i kënaqur me procedurën e trajtimit të ankesës ose përgjigjen që ka marrë nga sipërmarrësi, ai/ajo më pas do mund t'a përshkallëzojë çështjen tek autoritetet përkatëse rregullatore.

6. Informacion dhe këshilla

6.1 Sipërmarrësit pranojnë se janë prindërit apo kujdestarët ligjore që kanë përgjegjësinë kryesore për të siguruar se fëmijët e tyre do të edukohen siç duhet në lidhje me rrjetet, shërbimet dhe internetin, pavarësisht teknologjisë së përdorur. Kjo përgjegjësi mbështetet dhe nga Sipërmarrësit nëpërmjet angazhimit të tyre për t'ju ofruar klientëve këshilla mbi natyrën dhe përdorimin e pajisjeve dhe shërbimeve të reja dhe aksesin në rrjet.

6.2 Sipërmarrësit do t'iu ofrojnë këshillim klientëve dhe publikut të gjerë (përfshirë fëmijët, prindërit dhe kujdestarët) mbi natyrën dhe përdorimin e pajisjeve, shërbimeve të reja dhe aksesin në internet në përgjithësi si dhe do të mbështesin aktivitetet mediatike informuese që synojnë të përmirësojnë njohuritë e klientëve, aty ku është e mundur.

6.3 Këshillimi do të përfshijë nxitjen e prindërve për të biseduar me fëmijët e tyre për të trajtuar problemet që mund të lindin për shkak të përdorimit nga ana e fëmijëve të internetit dhe shërbimeve dhe pajisjeve nëpërmjet të cilave aksesojnë këto te fundit.

6.4 Kodi i Sjelljes dhe informacion tjetër shtesë ose Udhëzimet për Prindërit do të gjenden në faqen e internetit të secilit prej Sipërmarrësve.

7. Legjislacion shtesë, rregullore dhe klasifikime

7.1 Asgjë në këtë Kod nuk i shkarkon Sipërmarrësit nga përgjegjësia dhe detyrimi ligjor për të vepruar në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi në çdo kohe dhe rregulloret përkatëse.

7.2 Asgjë në këtë Kod nuk i ndalon Sipërmarrësit të klasifikojnë edhe me tej përmbajtjen komerciale, aty ku vlerësojnë se kjo ndarje mund të jetë e dobishme për klientët, në mënyrë që këta te fundit te vlerësojnë së cilës grup moshe i përshtatet një përmbajtje e caktuar.

7.3 Asgjë në këtë Kod nuk i ndalon Sipërmarrësit, kur është e mundur, të aplikojnë filtrimin teknik ose ndonjë lloj tjetër filtrimi për të minimizuar mundësinë që materialet e padëshiruara të aksesohen nëpërmjet internetit, shërbimeve apo pajisjeve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Zbatimi i Kodit

8.1 Në zbatim të këtij Kodi, Sipërmarrësit angazhohen si më poshtë:

- Sipërmarrësit janë përgjegjës për zbatimin e Kodit;


- Sipërmarrësit janë përgjegjës për publikimin në faqen e tyre zyrtare të internetit të këtij Kodi;
- Sipërmarrësit do të zbatojnë kushtet e Kodit nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkuara ndërmjet tyre dhe sa here që të jetë e mundur në marrëveshjet me palë të treta.
- Sipërmarrësit do të rishikojnë dhe përditësojnë Kodin në nivel industrie, kohe pas kohe, në mënyrë që ky Kod të jetë në përputhje me detyrimet ligjore dhe rregullatore ose kur kjo të jetë e nevojshme në mënyrë që Kodi t'iu përshtatet pritshmërive dhe nevojave të klientëve.
- Sipërmarrësit angazhohen të ofrojnë ndihmë ndaj agjencive strukturave të zbatimit të ligjit në hetimet penale.

9. Hyrja ne fuqi

Kodi hyn në fuqi me firmosjen e tij, nga sipërmarrësit dhe do të mbetet ne fuqi për një periudhë të pacaktuar kohore.

Nënshkrimi i Kodit është i hapur mbi baza vullnetare për të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e Ligjit 9918, date 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Shkurt 2013




 ALBTELECOM & EAGLE MOBILE sh.a.



 ABCOM sh.p.k.




 ALBANIA MOBILE COMMUNICATIONS sh.a.




 ABISSNET sh.a.




 VODAFONE ALBANIA sh.a.



 TRING TV sh.a.



 PLUS COMMUNICATIONS sh.a.



 Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit(AITA)

Nënshkruar më , 7 Shkurt 2013